



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

ANALIZA E PYETËSORIT NË LIDHJE ME PRIORITETET E PUBLIKUT
PËR PROJEKTBUXHETIN AFATMESEM 2024-2026

QËLLIMI I PYETËSORIT

Ky sondazh ka si qëllim të mundësojë pjesëmarrjen qytetare në vendimarrje duke mbledhur mendimin e komunitetit mbi mënyrën sesi bashkia I ka shpenzuar paratë gjatë vitit 2022 si dhe të ndihmojë keshillin bashkiak të kuptojë se cilat janë prioritet kryesorë të komunitetit në lidhje me buxhetin afatmesëm 2024-2026. Pyetësori merr mendimin edhe në lidhje me performancën e shërbimeve kryesore.

Bazuar në rezultatet e këtij pyetësori Këshilli Bashkiak Vau i Dejës do të hartojë një shkresë përcjellese në lidhje me kërkesat prioritare të komunitetit për shpenzime buxhetore e cila mendohet të ndihmojë administratën e përcaktimin e tavanëve përgatitore. Pyetjet bazohen në të dhënat faktike të vitit 2022.

Pyetësori është shpallur në faqen web të Keshillit Bashkiak dhe median sociale në datë 31 Janar 2023 dhe ka qendruar online deri në datë 5 mars 2023.

REZULTATET E SONDAZHIT

TE DHENA TE PERGJITHSHME

61 persona kanë plotësuar pyetësorin nga njësi administrative të ndryshme, ndër të cilat dallohet që ka një shumicë të lehtë femra me 54.2% dhe meshkuj 45.8%. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në pyetësor vijnë nga njësitë administrative të Bushatit me 29.1% dhe Vaut të Dejës me 27.3%, të ndjekur nga NjA Hajmel me 21.8%. Me pak pjesëmarrës ka patur nga Njësitë administrative të Shllakut, Temalit dhe Vig Mnelës me nga rreth 7% pjesëmarrës. Të gjitha njësitë administrative janë të perfaqësuara nga antare të komunitetit që kanë mbushur këtë pyetësor. Për më shumë informacion referojuni tabelave mëposhte:

Përcaktoni gjininë tuaj
59 responses




Tabela 1: Gjinia e pjesëmarrësve

Përcaktoni rezidencën tuaj
55 responses





Tabela 2: Vendbanimi i pjesëmarrësve



Pjesa me e madhe e pjesëmarrësve 47.9 % i perkasin grupmoshes 18-30 vjec, pra janë te rinjte shumica e pjesëmarrësve ne kete pyetesor cka tregon nje lehtësi te madhe per te perdorur teknologjine dhe angazhim me te madh te tyre ne qeverisjen vendore. Pjesëmarrësit vijne nga sektore te ndryshem te ekonomise. Edhe ketu pjesa me madhe 26.7% jane te rinj studentë, te ndjekur me pas nga vetëpunësuarit dhe te papunët me rreth 22% dhe vijon me te punësuarit ne administraten publike dhe sektorin privat. Për me shume informacion referojuni tabelave mëposhte:

Përcaktoni cilës grupmoshë i përkisni
48 responses



Unë jam (zgjidh nje nga opsionet)
45 responses




Tabela 3: Grupmosha e pjesëmarrësve

Tabela 4: Punësimi i pjesëmarrësve

MENDIMI I PJESËMARRËSVE NË LIDHJE ME SHPENZIMET BUXHETORE PËR SHËRBIMET KRYESORE

Sikurse vihet re nga grafiku në tabelën 5 ka nje dakordesi të pjesëmarrësve për mënyrën se si shpenzohen paratë nga Bashkia në 2 programe buxhetore në atë të Përkujdesjes sociale 82% dhe Planifikimit dhe administrimit (administrata) 70%, të dyja këto programe varen kryesisht nga transfertat qeveritare për qeverisjen vendore. Megjithatë qytetarët pjesëmarrës në pyetësor kërkojnë nga bashkia që të ketë me shumë vemendje nga bashkia për shërbimet që ajo u ofron qytetarëve duke kërkuar nga bashkia që shpenzojë më shumë para. Mbi 65% e pjesëmarrësve kërkojnë bashkia ti kushtojë vëmendje të vaçantë shërbimit të Menaxhimit i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit dhe Arsimit Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor, pra me shumë para për ujitjen dhe kullimin dhe edukimin te brezit te ri. Më pas rreth 57 % qytetarëve kërkon më shumë para për Rrjetin rrugor, Shërbimet publike dhe Mbrojtjen nga zjarri. Për më shumë informacion te tabela 5.

A jeni dakort me menyren si janë shpenzuar paratë? Shprehni opinionet tuaja në lidhje me këtë.




Tabela 5: Si janë shpenzuar paratë nga Bashkia



PERCEPTIMI QYTETAR PËR PUNËN E BASHKISË

Sikurse vihet re nga grafiku në tabelën 6 ka një dakordësi të pjesëmarrësve për performancën e bashkisë. Pjesa më e madhe e qytetarëve janë me punën e bashkisë për të gjitha shërbimet. Megjithatë sipas tabelës ka qytetarë që mendojnë se mund të punohet më mirë në disa shërbime si Rrjeti rrugor rural, Arsimi bazë dhe parashkollor, Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit dhe Mbrojtjes nga zjarri. Për më shumë informacion te tabela 6.

Si e vlerësoni performancën e bashkisë për shërbimet kryesore të ofruara?




Tabela 6: Vlerësimi i qytetarëve për punën e Bashkisë

PRIORITETET E KOMUNITETIT NE LIDHJE ME BUXHETIN 2024

Sikurse duket në grafikon e tabelën 7 programet me prioritare per komunitetin që qytetarët pjesëmarrës kanë zgjedhur 3 janë Arsimi Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor 41%, Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit dhe Rrjeti rrugor me nga 37%. Më pas me 30% Mbeshtetje për zhvillimin ekonomik dhe 28% Shërbimet publike nga Bashkia.

Prioriteti numër 1 pjesëmarrësve në pyetësor duket të jetë **Arsimi Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor**, pra në përgatitjen e buxhetit të ardhshëm bashkia duhet kushtojë me shumë vëmendje dhe para edukimit të brezit të ri. Një rëndësi të veçantë, Bashkia duhet ti kushtojë **ujitjes dhe kullimit** duke ju përgjigjur nevojave të fermerëve zonës, duke krijuar kushte për punësimin dhe ne vijim rritjen e prodhimit bujqësor dhe blegtoral. Edhe **rrjeti rrugor** kërkon një vëmendje me të madhe sipas mendimit qytetarëve, për ti shërbyer më mirë zhvillimit të gjithë bashkisë. Për më shumë informacion te tabela 7.



Prioritetet e komunitetit

61 responses




Tabela 7: Prioritetet e komunitetit për buxhetin e vitit 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKISË VAU DEJES

Nr. 1855 Prot.

Dt. 13.032023

Lenda: Rezultatet e Sondazhit të Prioriteteve të Komunitetit të Bashkisë Vau Dejes

Drejtuar: z. Mark Babani, Kryetari i Bashkisë

Për dijeni: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Vau i Dejes

I nderuar zoti Kryetar,

Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë dhe Buxhetit, i mbledhur me datën 06.03-2023, pasi shqyrtoi rezultatet e sondazhit të prioriteteve të komunitetit për Projektbuxhetin Afatmesëm 2024-2026 dhe me anë të kësaj shkrese kërkon reflektimin e kërkesave të qytetarëve që dalin nga sondazhi i organizuar nga Këshilli Bashkiak në buxhetin 2024 si pjesë e Projekt Buxhetit 2024-2026 brenda kapaciteteve financiare dhe prioriteteve strategjike të Planit të Përgjithshëm Vendor.

Komisioni kërkon që të rritet buxheti i bashkise për:

1. Arsimin Baze dhe Parashkollor
2. Rrjetin rrugor
3. Menaxhimin e Infrastruktues se Ujitjes dhe Kullimit.

Komisioni pret reagimin e Tuaj në lidhje me kërkesat e komunitetit.

Këtij dokumenti i bashkagjitet edhe dokumenti i analizës së sondazhit për përcaktimin e prioriteteve të komunitetit.

Kryetar i Këshillit

Mark Babani

Sekretari i Këshillit

Adria Çelepi

Kryetar Komisionit

Gjon Pleshaj

